



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 89

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 19 qershor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 7.6.2018	Për emërim në detyrë..... 5595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 12.6.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 911, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin “RSM”, në shtabe të ndryshme të NATO-s, në Afganistan”..... 5595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 344, datë 12.6.2018	Për një shtesë në vendimin nr. 561, datë 29.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”..... 5595
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 345, datë 12.6.2018	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2018..... 5596
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 12.6.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 832, datë 3.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”..... 5596
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 12.6.2018	Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar..... 5597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.6.2018	Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre..... 5598

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 12.6.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Linja e re e furnizimit me ujë të Ujësjiellit Durrës”.....	5602
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 12.6.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 101, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”.....	5605
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 12.6.2018	Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative.....	5606
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 4.6.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me fuqi të instaluar 1998 kw.....	5610
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 4.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “BLAÇ Energy” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga HEC “BLAÇ”, me fuqi të instaluar 1300 kw.....	5612
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 4.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë ALBGAS sh.a.....	5612
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 121, datë 4.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAS sh.a.....	5615
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 122, datë 4.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së Furnizimit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 e vlefshme deri më datë 8.7.2021 të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.).....	5617
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 123, datë 4.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së operimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e bordit të komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2044 të shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.).....	5618
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 124, datë 4.6.2018	Mbi mosfillimin e procedurës, për modifikimin e licencës së shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., me nr. 349 licence, seria PV16K, miratuar me vendimin e bordit nr. 140, datë 15.8.2016, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1”, me fuqi të instaluar 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi të instaluar 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw.....	5620
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 125, datë 4.6.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 kw.....	5621
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 4.6.2018	Mbi licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	5622
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Petrit Çela....	5623

**VENDIM****Nr. 342, datë 7.6.2018****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Gent Cakaj emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 343, datë 12.6.2018**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 911, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM”, NË SHTABE TË NDRYSHME TË NATO-s, NË AFGANISTAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 911, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Numri “...11 (njëmbëdhjetë) ...” ndryshohet dhe bëhet “...15 (pesëmbëdhjetë) ...”;

b) Paragrafi i fundit së bashku me ndarjet ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në Shtabin e Trajnim - Këshillimit dhe Ndihmës (TAAC-West), në operacionin “RSM”, në Herat, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 6 (gjashtë) ushtarakë;
- Venddislokimi, Herat, Afganistan.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 344, datë 12.6.2018**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 561, DATË 29.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “Për STANDARDIZIMIN DHE DISIPLINIMIN E SHPENZIMEVE TË KARBURANTIT NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1, të vendimit nr. 561, datë 29.7.2016, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1 Bëjnë përjashtim nga pika 1, e këtij vendimi, strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit, të cilat, për shkak të natyrës së punës, mund të përdorin kartë elektronike që nuk mundëson identifikimin e mjetit të transportit dhe të përdoruesit të saj, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 345, datë 12.6.2018****PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ORGANIKË NË NJËSITË
E QEVERISJES QENDRORE
PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), për vitin 2018, pakësohet me 50 veta, përkatësisht, 5 punonjës të aparatit të ministrisë dhe 45 punonjës të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 1 947 veta.

2. Numri i punonjësve të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (AMBU), për vitin 2018, shtohet me 5 punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 28 veta.

3. Numri i punonjësve të sistemit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2018, shtohet me 45 punonjës për Inspektoratën Shtetërore të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, duke e çuar numrin e përgjithshëm të ministrisë në 1080 veta.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 346, datë 12.6.2018****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 832, DATË 3.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME
ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE
TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE
TREGTARE, QË VEPROJNË NË
SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 8334, datë 23.4.1998, “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 832, datë 3.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pjesën hyrëse të vendimit të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi parë i pikës 2 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Dokumentacioni i privatizimit i përgatitur nga ekspertët vlerësues përmban: ... “;

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 e 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.1. Dokumentacioni i privatizimit, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar në urdhrin e ministrit, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore, i dërgohet Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, të krijuar me urdher të ministrit përgjegjës për ekonominë, për verifikimin, konfirmimin dhe transparencën e procedurave të vlerësimit dhe hartimit të dokumentacionit për paketat shtetërore të aksioneve që dërgohen për shitje/privatizim;

2.2. Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës i rekomandon ministrit përgjegjës për ekonominë vijimin e procedurës së privatizimit nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nëse ekziston dokumentacioni i kërkuar ligjor dhe ka kaluar në të gjitha strukturat e parashikuara në këtë vendim.



Në rast të kundërt, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës kërkon plotësimin e dokumentacionit.”.

2. Në kreun I bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, të shkronjës “A”, fjalët “... në dy gazeta me qarkullim kombëtar, nga një botim në secilën gazetë ...” zëvendësohen me “... në Buletin e Njoftimeve Zyrtare ...”, ndërsa shprehja “... në televizion dhe ...” hiqet.

b) Në pikën 1, të shkronjës “C”, në vazhdim të fjalëve “... në mbështetje të...” shtohet “... ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, ...”.

3. Kudo në vendim, emërtimi “Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” zëvendësohet me “Agjencia e Trajtimit të Pronës”, emërtimi “Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike” zëvendësohet me fjalët “... struktura përgjegjëse për shitjen e pronës ...”, ndërsa fjalët “... ministria përgjegjëse për ekonominë ...” dhe emërtimi “Ministria e Financave” zëvendësohen me emërtimin “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 347, datë 12.6.2018

**PËR NJË SHITESË FONDESH NË
BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE
MJEDISIT, MINISTRINË E FINANCVE
DHE EKONOMISË DHE MINISTRINË
E INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË, PËR PAGESËN E
SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR
PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË
ÇËSHTJET E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2018 bëhet një shtesë fondesh, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlehtë në lekë e fondit 516 146 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e gjashtë) euro dhe 99 660 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) paundë për kryerjen e pagesave të faturave të firmës avokatore “Gowling WLG” në çështjen e Arbitrazhit Ndërkombëtar “ICSID, nr. Arb/14/26”, me palë “Albaniabeg Ambient, sh.p.k”, “M.Angelo Novelli” dhe “Costruzioni S.R.L.” kundër Republikës së Shqipërisë;

b) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlehtë në lekë e fondit 1 000 000 (një milion) euro për kryerjen e pagesave të shërbimeve juridike në çështjen e Arbitrazhit Ndërkombëtar “ICSID case no.ARB/17/6” me palë “Anglo-Adriatic Group Limited” kundër Republikës së Shqipërisë;

c) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin “Mbështetje për energjinë”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlehtë në lekë e fondit 600 000 (gjashtëqind mijë) euro për kryerjen e pagesave të faturave të firmës avokatore “Gowling WLG” për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e Arbitrazhit Ndërkombëtar “ICC kundër Hydro S.R.L.”.

2. Efekti financiar, i parashikuar në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 349, datë 12.6.2018****PËR MIRATIMIN E MASAVE
MBËSHKETËSE PËR NXITJEN E
PËRDORIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA BURIMET E
RINOVUESHME TË DIELLIT DHE
ERËS, SI DHE TË PROCEDURAVE PËR
PËRZGJEDHJEN E PROJEKTEVE PËR
PËRFITIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre, në mbështetje të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme.

2. Masat mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës jepen nëpërmjet një procesi konkurrues, të hapur, transparent dhe jodiskriminues, i cili siguron besueshmëri për pjesëmarrësit dhe garanton dhënien e këtyre masave subjekteve që ofrojnë kushtet më të mira për sa i përket çmimit të energjisë, teknologjisë së përdorur dhe mënyrës së ndërtimit të impiantit.

3. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Masa mbështetëse” për efekt të këtij vendimi, masat e parashikuara në pikën 5, të kreut I, të këtij vendimi që kanë si qëllim nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës;

b) “Proces konkurrues”, procedura e hapur, transparente dhe jodiskriminuese, që mundëson pjesëmarrjen e shoqërive tregtare ose bashkimit të shoqërive tregtare, me qëllim dhënien e masave mbështetëse, në përputhje me dispozitat e këtij vendimi;

Faqe | 5598

c) “Autoriteti kontraktues”, ministria përgjegjëse për energjinë;

ç) “Ministri”, ministri përgjegjës për energjinë;

d) “Ofertues”, shoqëria ofertuese ose bashkimi i shoqërive ofertuese që paraqet ofertë në përputhje me përcaktimet e dokumenteve të procesit konkurrues;

dh) “Komision i posaçëm”, komisioni i krijuar me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë, që përbëhet nga anëtarë specialistë, të cilët kanë njohuritë e duhura teknike, juridike dhe ekonomike;

e) “Dokumentet e procesit konkurrues”, dokumentet, të cilat hartohen nga komisioni i posaçëm i ofertave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, të cilat përcaktojnë formën, kriteret dhe procedurat e pjesëmarrjes, të shqyrtimit të ofertave dhe përzgjedhjes së ofertuesit më të mirë;

ë) “Sigurimi i ofertës”, dokumenti në formën e garancisë bankare të pakushtëzuar, që do të dorëzohet nga ofertuesi së bashku me ofertën;

f) “Garancia e kontratës”, dokumenti në formën e garancisë bankare të pakushtëzuar që do të dorëzohet nga ofertuesi i përzgjedhur përpara nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare;

g) “Kontrata për blerjen e energjisë elektrike”, modeli i kontratës, e lidhur ndërmjet ofertuesit të përzgjedhur dhe operatorit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike prej një kapaciteti gjenerues nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, e cila bazohet në garantimin e blerjes së energjisë elektrike me një tarifë të pandryshuar, vlera e të cilit do të dalë nga procesi konkurrues;

gj) “Ofertues i përzgjedhur”, ofertuesi më i mirë i përzgjedhur sipas procedurës konkurruese për zhvillimin e projektit të përzgjedhur për prodhimin e energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme të erës dhe/ose diellit;

h) “Operatori i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”, operatori i energjive të rinovueshme, përgjegjës për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave;

i) “Projekti”, kapaciteti gjenerues i instaluar (në MW) për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit ose erës, i cili do të realizohet nga ofertuesi i përzgjedhur për përfitimin e masave mbështetëse, në bazë të procedurave konkurruese, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;



j) “Shoqëria e projektit”, shoqëria për qëllime të veçanta, që do të themelohet nga ofertuesi i përzgjedhur për realizimin e projektit;

k) “Tarifa e miratuar nga ERE”, tarifa e miratuar nga ERE për energjinë e prodhuar nga dielli dhe era, me vendimin nr. 120, datë 27.7.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MË”, në përputhje me metodologjinë e miratuar me vendimin nr. 369, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”;

l) “Kontrata për diferencë”, modeli i kontratës së lidhur ndërmjet ofertuesit të përzgjedhur dhe operatorit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, e cila bazohet në formën e një shpërblimi për arritjen e çmimit të ofertuar në procedurën konkurruese, si një shtesë mbi çmimin e tregut të ditës në avancë.

4. Çdo term tjetër i përdorur në këtë vendim do ketë kuptimin e dhënë në ligjin nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

5. Me qëllim arritjen e objektivit kombëtar të përcaktuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në mënyrën më efektive, miratohen masat mbështetëse, si më poshtë vijon:

a) Garantimi i kontratës për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar, me një kohëzgjatje maksimale për 15 vjet, duke filluar nga data e dhënies së certifikatës së përdorimit të projektit, në përputhje me marrëveshjen që do të nënshkruhet me autoritetin kontraktor;

b) Kalimi, në administrim të autoritetit kontraktor, i pasurive të paluajtshme për realizimin e shfrytëzimin e projektit dhe vënien e tyre në dispozicion të shoqërisë së projektit për të gjithë kohëzgjatjen e tij, në përputhje me marrëveshjen që do të nënshkruhet me autoritetin kontraktor dhe legjislacionin në fuqi;

c) Garantimi i lidhjes dhe aksesit për përdorimin e rrjetit të transmetimit/shpërndarjes së energjisë së prodhuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) Garantimi nga ana e autoritetit kontraktues i ndjekjes të të gjitha procedurave për marrjen e lejeve dhe autorizimeve të nevojshme për zbatimin dhe shfrytëzimin e projektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) Mbështetja sipas kontratës për diferencë.

6. Procesi për dhënien e masave mbështetëse duhet të garantojë:

a) Arritjen e objektivit për përdorimin e energjisë së rinovueshme në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë brenda afatit kohor të caktuar;

b) Dhënien e mbështetjes për blerjen e energjisë me koston më të ulët të mundshme dhe efektivitetin më të madh;

c) Besueshmërinë e ofertave dhe realizimin e plotë të projektit;

ç) Të qenit transparent, i hapur, jodiskriminues, objektiv, si dhe sigurimin e besimit të gjerë të investitorëve;

d) Minimizimin e deformimeve të tregut të energjisë dhe lehtësimin e zhvillimit të tij.

II. ZHVILLIMI I PROCESIT PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTTIT QË DO TË PËRFITOJË MASAT MBËSHTETËSE

1. Ministri autorizon fillimin e procesit konkurrues për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse, duke përcaktuar të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Kapacitetin e instaluar të projektit që do të përfitojë masat mbështetëse;

b) Llojin e teknologjisë së projektit;

c) Vendndodhjen e projektit;

ç) Kushtet për lidhjen me rrjetin, si dhe rregullat për balancimin dhe dispeçerimin;

d) Operatorin përgjegjës të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë;

dh) Dokumentet e nevojshme për zhvillimin e procesit konkurrues;

e) Kriteret e vlerësimit të ofertave;

ë) Afatin e përfundimit të projektit dhe të marrjes së certifikatës së përdorimit.

2. Ministri ngre komisionin e posaçëm, i cili ka këto kompetenca:

a) Harton, brenda 30 ditëve, dokumentet e procesit konkurrues, që specifikojnë mënyrën e zhvillimit të procesit konkurrues për përfitimin e masave mbështetëse;

b) Harton kriteret e veçanta të aplikimit dhe të



kualifikimit, bazuar në përcaktimet e pikës 6, të kreut II;

c) Harton metodologjinë e vlerësimit, e cila është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues;

ç) Vlerëson ofertat e ofertuesve bazuar në kriteret e kualifikimit të ofertës;

d) Harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe e paraqet për miratim pranë ministrit;

dh) Mund të angazhojë ekspertizë të veçantë vendase ose të huaj për të asistuar gjatë zhvillimit të procesit;

e) Çdo funksion tjetër bazuar në parashikimet e këtij vendimi.

3. Dokumentet e procesit konkurrues, ndër të tjera, përmbajnë:

a) Ftesën për ofertë, e cila publikohet së paku në dy buletine të njoftimeve zyrtare dhe dy gazeta ndërkombëtare, si dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

b) Udhëzuesin për pjesëmarrës në proces;

c) Sigurimin e ofertës, i cili lëshohet nga një institucion bankar i besueshëm dhe në formatin e parashikuar në dokumentet e procesit konkurrues;

ç) Afatin e vlefshmërisë së ofertës;

d) Pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në proces;

dh) Kriteret bazë të aplikimit dhe të kualifikimit;

e) Kriteret e vlerësimit të ofertave;

ë) Garancinë e kontratës, e cila lëshohet nga një institucion bankar i besueshëm dhe siguron përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të marrëveshjes;

f) Afatin e paraqitjes së ofertave, i cili në çdo rast nuk do të jetë më pak se 30 ditë;

g) Çdo dokument tjetër që do të vlerësohet nga komisioni i posaçëm në përmbushje të kriterëve të kualifikimit.

4. Dokumentet e procesit konkurrues duhet të përfshijnë edhe parimet e mëposhtme referuar tarifës për marrëveshjen e blerjes së energjisë:

a) Tarifa duhet të jetë në euro/MWh;

b) Tarifa duhet të jetë e nivelizuar dhe e pandryshuar për një periudhë deri në 15 vjet;

c) Tarifa tavan nuk duhet jetë më e lartë se tarifa për të njëjtën teknologji, e miratuar nga ERE.

5. Dokumentet e procesit konkurrues duhet të përfshijnë parimet e mëposhtme, duke iu referuar pagesës sipas kontratës së blerjes së energjisë:

a) Mënyra e kryerjes së pagesave dhe penaltitetet për pagesa të vonuara;

b) Përcaktimi i një mekanizmi të duhur të sigurimit të pagesave të energjisë së prodhuar.

6. Për të siguruar që ofertuesit kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e projektit, komisioni i posaçëm do të bazohet në kriteret bazë të aplikimit dhe të kualifikimit, në të cilat, ndër të tjera, përfshihen:

a) Kriteret ligjore:

i. Ekstrakti tregtar i shoqërisë/apo bashkimit të shoqërive. Në rast të bashkimit të shoqërive, ofertat e dorëzuara duhet të shoqërohen me një marrëveshje të përbashkët të ofertimit midis anëtarëve të bashkimit;

ii. Vërtetime për shlyerjen e detyrimeve tatimore, pagesën e sigurimeve shoqërore, pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike dhe të ujësjellës-kanalizimeve dhe që shoqëria nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

iii. Shoqëria apo bashkimi i shoqërive, si dhe drejtuesit e shoqërisë ofertuese, ose e ndonjë prej shoqërive pjesëmarrëse në bashkimin e shoqërive ofertuese, nuk duhet të jenë në ndjekje penale ose të jenë dënuar me një vendim të formës së prerë.

b) Kriteret financiare:

i. Çdo dokumentacion të nevojshëm që vërteton gjendjen financiare të kompanisë dhe provon aftësinë e saj financiare për të realizuar projektin, sipas dokumenteve të procesit konkurrues;

ii. Pasqyrat financiare, të audituara nga audituesit e licencuar, të tri viteve të fundit të veprimtarisë dhe të depozituara në organet tatimore ose, kur shoqëria ka më pak se tre vjet që është krijuar, për periudhën e ekzistencës së saj, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar që provon aftësitë financiare për të realizuar projektin e propozuar, shoqëruar prej vërtetimit të licencës së audituesit;

iii. Garanci bankare në sigurimin e fondeve, e cila vlerësohet bazuar në përvojën e mëparshme në sigurimin e fondeve nga ana e ofertuesit ose çdo letër mbështetëse për financimin e projektit të marrë nga një institucion bankar i besueshëm.

c) Kriteret teknike:

i. Shoqëria ofertuese ose bashkimi i shoqërive ofertuese duhet të kenë përvojë në të shkuarën për realizimin dhe shfrytëzimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme prej diellit dhe/ose erës;

ii. Në varësi të teknologjisë së përzgjedhur, modulet e paneleve diellore apo të turbinave eolike, inverterat dhe komponentët e tjerë elektrikë dhe elektro-mekanikë, si dhe lidhjet elektrike dhe ndërfaqësimet software dhe hardware të jenë në



përputhje me kërkesat e rrjetit, si dhe të sigurojnë ofrimin e të dhënave reale metrike diellore dhe/ose eolike lidhur me prodhimin e pritshëm vjetor të energjisë;

iii. Aparaturat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe kriteret e veçanta të përcaktuara nga komisioni i posaçëm.

ç) Kriteret e përvojës në fushën e energjisë së rinovueshme:

i. Përvojë në ndërtimin e të paktën një centrali të një kapaciteti të ngjashëm;

ii. Përvojë në ndërtimin dhe operimin e të paktën një centrali me kapacitet të ngjashëm të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të rinovueshme;

iii. Përvojë në ushtrimin e aktiviteteve të biznesit në Shqipëri prej shoqërisë ofertuese ose të paktën të njërit nga anëtarët e bashkimit të shoqërive ofertuese.

d) Kriteri i besueshmërisë:

i. Nuk duhet të jetë ose të ketë qenë objekt i penaliteteve ligjore dhe tatimore gjatë veprimtarisë së tyre nga institucionet/agjencitë shqiptare dhe/ose prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian;

ii. Nuk duhet të jetë i/e listuar që t'i kufizohet ushtrimi i aktivitetit në Shqipëri ose në vendet anëtare të Bashkimit Evropian;

dh) Kriteria të tjera të vlerësimit të ofertës:

i. Ofertuesit duhet të ofrojnë një tarifë të nivelizuar 15-vjeçare në euro/MWh, e cila do të jetë pjesë e kriterëve të vlerësimit dhe në çdo rast nuk duhet jetë më e lartë se tarifa për të njëjtën teknologji, e miratuar nga ERE, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues;

ii. Ofertuesit duhet të garantojnë ndërtimin e kapaciteteve të tjera shtesë, përveç atyre të parashikuara si pjesë e masave mbështetëse, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

7. Të drejtën për të aplikuar e ka:

a) Çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese, që plotëson kriteret e përcaktuara në dokumentet e procesit konkurrues, të parashikuara në këtë vendim;

b) Çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese që provojnë kapacitetin teknik, financiar dhe të besueshmërisë për të zhvilluar projektin e specifikuar sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në pikën 6, të kreut II, të këtij vendimi.

c) Çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese që paguan tarifat e pjesëmarrjes në procesin

konkurrues, siç specifikohet në dokumentet e procesit konkurrues.

8. Komisioni do të vlerësojë vetëm ofertat e atyre ofertuesve që kanë paraqitur aplikimin e plotë sipas këtij vendimi dhe dokumenteve të procesit dhe që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes në proces.

9. Kostot e zhvillimit të procedurës së mësipërme mbulohen nga ofertuesi i përzgjedhur fitues për ndërtimin e impiantit.

III. VLERËSIMI I OFERTAVE, NEGOCIMI DHE LIDHJA E MARRËVESHJES PËRFUNDIMTARE ME OFERTUESIN E PËRZGJEDHUR

1. Ofertat e ofertuesve do të vlerësohen sipas kriterëve të kualifikimit të ofertës të përcaktuara në pikën 6, të kreut II, bazuar në një metodologji të vlerësimit të ofertave, të përbërë me pikë të ndara sipas secilit kriter.

2. Metodologjia e vlerësimit është pjesë e dokumenteve të procesit konkurrues.

3. Për secilin prej kriterëve të vlerësimit, ofertuesit duhet të sigurojnë dokumentet e nevojshme, sipas përcaktimeve në dokumentet e procesit konkurrues.

4. Ofertuesi me rezultatin më të lartë, sipas metodologjisë së vlerësimit të ofertës, shpallet ofertuesi i përzgjedhur.

5. Në përfundim të vlerësimit të ofertave, komisioni i posaçëm paraqet për miratim pranë ministrit raportin përfundimtar të vlerësimit.

6. Ministri autorizon negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes përfundimtare me ofertuesin e përzgjedhur, që përmban të gjitha elementet për zbatimin e suksesshëm të projektit.

7. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të formojë një shoqëri për projektin për të hyrë në marrëveshje përfundimtare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të zotërojë jo më pak se 51% të aksioneve të kapitalit në shoqërinë e projektit për të paktën tre vjet nga data e operimit tregtar.

9. Para nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare, ofertuesi i përzgjedhur/shoqëria e projektit duhet të paraqesë garancinë e kontratës, sipas përcaktimeve të dokumenteve të procesit konkurrues.

10. Ofertuesi i përzgjedhur duhet të garantojë respektimin e rregullave të tregut, si dhe të kërkesave teknike të rrjetit dhe balancimit të ngarkesës në Shqipëri.



IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Mbështetja sipas kontratës për diferencë bëhet e aplikueshme me krijimin e një tregu funksional të ditës në avancë të aksesueshëm për prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit e të erës dhe të bërjes efektive të bursës shqiptare të energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 351, datë 12.6.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I OBJEKTIT “LINJA E RE E
FURNIZIMIT ME UJË TË
UJËSJELLËSIT Durrës”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit “Linja e re e furnizimit me ujë të ujësjellësit Durrës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Durrës sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen me vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “Tokë bujqësore” dhe “Drufrutorë”, me një vlerë të përgjithshme prej 7 760 025 (shtatë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e pesë) lekësh, nga të cilat:

a) “Tokë bujqësore”, në vlerën 7 578 000 (shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë;

b) “Drufrutorë”, në vlerën 182 025 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëzet e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 760 025 (shtatë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e pesë) lekësh, do të përballohet nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve, zëri “Kodi i Projektit, M063149”, parashikuar në buxhetin e vitit 2018.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë.

7. Pronarët, sipas emrave të shënuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Durrës sh.a.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Durrës sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin dhe shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Durrës sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama



SHOQËRIA UJËSJELLËS–KANALIZIME DURRES SHA
PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT “LINJA E RE E FURNIZIMIT ME UJË TË UJËSJELLËSIT DURRES”

Tabelë. Lista e pronarëve që do të shpronësohen nga ndërtimi i ujësjellësit (vend burimi Fushë-Milot, Fushë-Kuqe, Vlashaj dhe Bodinok)

Nr.	Komuna / fshati	Emërtimi	Emër mbiemër i pronarit	Nr. i parcelës	Nr. kadastrës	Nr. i pronarëve	Statusi ligjor i pronësisë	Tipi i tokës	Sipërfaqe totale (m ²)	Vlerësimi i sipërfaqes për shpronësim (m ²)				Vlerësimi i bimësisë për kompensim (ALL)			Shuma totale e kompensimit
										Sipërfaqe që shpronësohet (m ²)	Çmim (ALL/ m ²)	Vlera e shpronësimit (ALL)	Statusi ligjor në ZRPP	Bimë të arave (ALL)	Drufrutorë (ALL)	Vlera e kompensimit (ALL)	
1	Milot Mal Bardhë	PP	Nezir Ymeri	70/37	2580	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	3000	625	1,000	625,000	Regjistruar	-	-	-	625,000
2	Fshati Fushë Milot	PM	Fatmir Haliti	20/1	1812	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	12835	4	1,000	4,000	Regjistruar	-	-	-	4,000
4	Fshati Fushë Milot	PM	Fran Lleshi	33/24	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	3300	4	1,000	4,000	Regjistruar	-	-	-	4,000
5	Fshati Fushë Milot	PP	File Veseli, Fitnete Veseli, Flutura Veseli, Naime Veseli, Sara Veseli	42/34	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	2500	625	1,000	625,000	Regjistruar	-	-	-	625,000
6	Fshati Fushë Milot	PP	Ferdinant Kolaj	39/50	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	3380	625	1,000	625,000	Regjistruar	-	121.350	121.350	746,350



7	Fshati Fushë Milot	PM	Leon Marku	36/100	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	3295	4	1,000	4,000	Regjistruar	-	-	-	4,000
8	Fshati Shellinxhe	SP	Zef Curri	7/2	3332	1	Regjistruar Pona me Urdher Kufizimi	Tokë Bujqësore	19865	742	1,000	742,000	Regjistruar	-			742,000
9	Fshati Fushë Kuqe	SP	Frrok Keci,Liza Keci,Marije Keci,Age Keci,Alfred Keci,Vitore Keci,Fation Keci,Elvis Keci,Daniela Keci, Prengë Keci	7/5	3332	10	Regjistruar	Tokë Bujqësore	6000	4390	1,000	4,390,000	Regjistruar	-			4,390,000
10	Fshati Fushë Kuqe	PM	Llesh Duli	1614/2	1673	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	24681	4	1,000	4,000	Regjistruar	-			4,000
11	Fshati Gorre	PM	Fran luc Çuli	2/2	1812	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	3847	4	1,000	4,000	Regjistruar	-	-	-	4,000
12	Vlashaj/Maminas	DP	Seit Cenaliu	370/112	3796	1	Regjistruar	ullishte	1323	460	1,000	460,000	Regjistruar	-	60,675	60,675	520,675
13	Bodinok/Maminas	DP	Hamdi Seferi	309	1233	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	1067	91	1,000	91,000	Regjistruar	-	-	-	91,000
	TOTAL									7,578	7,578.000				182,025	182,025	7,760.025

**VENDIM****Nr. 352, datë 12.6.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 101, DATË 4.2.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
PAKETËS SË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE, NË KUJDESHIN
SHËNDETËSOR PARËSOR PUBLIK, QË
FINANCOHET NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESHIT SHËNDETËSOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 101, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Shtojca 2, “Barna dhe materiale konsumi në QSH”, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kudo në tekstin e vendimit, fjalët “Ministria/së e/së Shëndetësisë”, zëvendësohen me “ministra/së përgjegjëse për shëndetësinë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 2**LISTA E BARNAVE DHE MATERIALEVE MJEKËSORE TË QENDRËS SHËNDETËSORE**

Nr.	Principi aktiv	Formë/doza	Njësia	Sasia
1	Ujë për injeksion	2ml	ampulë	30
2	Atropine Sulphate	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë	30
3	Glucose	Solucion për infuzion 5% - 500ml	flakon	10
4	Glucose	Solucion për injeksion 4g/10ml - 10ml	ampulë	10
5	Diazepam	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë	20
6	Adrenaline	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë	20
7	Furosemide	Solucion për injeksion 20mg/2ml - 2ml	ampulë	20
8	Sodium Chloride	Solucion për injeksion 85mg/10ml	ampulë	20
9	Sodium Chloride	Solucion për infuzion 9g/1000ml - 500ml	flakon	5
10	Magnesium sulphate	Solucion për injeksion 2.5g/10ml - 10ml	ampulë	10
11	Nitroglycerine	0.3 mg/tab	tabletë	50
12	Epinefrine	0.1%- 1ml	ampulë	20
13	Phytomenadione (vitamina K)	Solucion për injeksion 1% - 1 ml	ampulë	30
14	Dexamethasone sodium phosphate	Solucion për injeksion 4mg/ml - 1ml	ampulë	20
15	Prednisolon	25mg/2ml	ampulë	20
16	Aminophylline	250mg/10ml	ampulë	10
17	Serum antitetanus (Human tetanus immunoglobulin)	Solucion për injeksion 250 IU/1ml	shiringë e p.përgatitur	20
18	Viper venom antiserum	Solucion për injeksion glass vial x 5ml	flakon	10
19	Haloperidol	Solucion për injeksion 5mg/ml - 1ml	ampulë	10
20	Metoclopramide hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë	20
21	Acetylsalicylic acid	500 mg/ tab	tabletë	50
22	Morphine hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/ml - 1ml	ampulë	10
23	Tramadol hydrochloride	Solucion për injeksion x100mg/2ml-2ml	ampulë	20
24	Diclofenac sodium	Solucion për injeksion 75mg/ 3ml	ampulë	20
25	Salbutamol (as Salbutamol sulphate micronised)	Suspension inhalues i presuar 100µg/actuation - 200 doses	flakon	10
26	Dihydroergotamine	1mg/ml	ampulë	20
27	Papaverine hydrochloride	Solucion për injeksion 40mg/ml - 1ml	ampulë	20



28	Oxytocine	Solucion për I.M./I.V. injeksion 10 IU/1ml	ampulë	10
29	Alcohol ethilic	70%- 100 ml/1000ml	flakon	2
30	Povidone Iodine	solucion cutan 10g/100ml	flakon	2
31	Chlorpheniramine Maleate	4mg/tab	tabletë	50
32	Silver sulphadiazine	Krem 10mg/g - 50mg	tubet	5
33	Hidrokortizon	1%- 10 mg/g-30g	tubet	5
34	Acetaminophen (Paracetamol)	500mg /tab	tabletë	20
35	Acetaminophen (Paracetamol)	100 mg /supost	supp.	20
36	Magnesium Hydroxide + Aluminum Hydroxide	400mg + 400mg/tab	tabletë	30
37	Ranitidine hydrochloride	Solucion për injeksion 50mg/2ml - 2ml	ampulë	10
38	Silver nitrate (Nitrat argjendi)		copë	2
39	Atenolol	100 mg/tab	tabletë	50
40	Nifedipine	10 mg/tab	tabletë	30
41	Hyoscine butylbromide	Solucion për injeksion 20mg/ml - 1ml	ampulë	20
42	Lanatoside C	Solucion për injeksion 0.4mg/2ml - 2ml	ampulë	10
43	Amiodaron hydrochloride	200 mg/tab	tabletë	20
44	Acid folic	5mg/tab	tabletë	100
45	Peroksid Hidrogjeni 3%	Solucion 30mg/ml - 100ml	flakon	5
46	Oksigjen		bombola	2
47	Nebulizator ose pompë me volumatik		copë	2
48	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, paketë 100g	copë	30
49	Sistem perfuzioni plastik		copë	10
50	Shiring plastike + 2 age 3 ml		copë	30
51	Shiring plastike + 2 age 5 ml		copë	30
52	Shiring plastike + 2 age 10 ml		cope	30
53	Penj për qepje plagësh		paketa	10
54	Doreza kirurgjikale		copë	50
55	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	copë	30
56	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitëse e mbrojtur me letër të shqitshme	copë	30
57	Garzë 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendësia 24x20	m. linear	50
58	Agrafe kirurgjikale			50

VENDIM**Nr. 353, datë 12.6.2018**

**PËR RREGULLAT E FUNKSIONIMIT
TË GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL
PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, PRANË
BASHKIVE DHE NJËSIVE
ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 52, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të funksionimit të grupi teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive apo njësive

administrative, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

**RREGULLA****PËR FUNKSIONIMIN E GRUPIT TEKNIK,
NDËRSEKTORIAL, PËR MBROJTJEN E
FËMIJËVE, PRANË BASHKIVË DHE
NJËSIVË ADMINISTRATIVE****I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e grupit teknik, ndërsektorial, për mbrojtjen e fëmijëve janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë anëtarët e tij të përhershëm, si dhe anëtarët e thirrur mbi bazën e nevojave të rastit.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet dhe shkurtime, si më poshtë vijon:

- “Agjencia” - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

- “GTN” - grupi teknik, ndërsektorial;

- “Këshilli” - Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;

- “Ligji” - ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

- “Ministri bashkërendues” - ministri përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

- “NJMF” - njësia e mbrojtjes së fëmijëve në bashki;

- “NJVRN” - Njësia për vlerësimin dhe referimin e nevojave;

- “OJF” - organizatë jofitimprurëse;

- “PIM” - plani individual i mbrojtjes;

- “PMF” - punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve;

- “SHSSH” - Shërbimi Social Shtetëror.

3. Grupi teknik, ndërsektorial, gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, duhet të kujdeset që të zbatohen këto parime:

a) Parandalimi i abuzimit, neglizhimit të fëmijëve dhe minimizimi i dëmit të mëtejshëm;

b) Konsiderimi parësor i sigurisë dhe mirëqenies së fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet e marra për fëmijën;

c) Ruajtja e fshehtësisë dhe konfidencialitetit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje në trajtim;

ç) Respektimi i vlerave kulturore e tradicionale të fëmijës dhe familjes së tij/saj, pa cenuar sigurinë, të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

d) Ndërtimi i partneritetit me familjen e fëmijës në shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve që lidhen me fëmijën në nevojë për mbrojtje;

dh) Marrja në konsideratë e mendimit dhe përfshirja e fëmijës në vendimet që merren apo që kanë lidhje me të, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar.

**II. RREGULLAT PËR ÇAKTIMIN E
ANËTARËVE TË GRUPIT TEKNIK,
NDËRSEKTORIAL**

1. Grupi teknik, ndërsektorial funksionon si një grup *ad-hoc* në çdo bashki dhe njësi administrative bashkiake që ka mbi 3 000 fëmijë dhe ka për qëllim trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

2. Grupi teknik, ndërsektorial mbledhet me kërkesë të drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie ose të punonjësit të mbrojtjes së fëmijës në nivel njësie administrative.

3. Grupi teknik, ndërsektorial përbëhet nga:

a) Përfaqësues të strukturave të policisë;

b) Përfaqësues të strukturave të shërbimeve sociale;

c) Përfaqësues të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar;

ç) Përfaqësues të strukturave shëndetësore;

d) Përfaqësues të strukturave të drejtësisë;

dh) Përfaqësues të organizatave jofitimprurëse;

e) Çdo specialist tjetër, që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës.

4. Pjesëmarrja në GTN e përfaqësuesve të strukturave të sipërpërmendura është e detyrueshme. NJMF-ja ka detyrimin të identifikojë profesionistët dhe strukturat shërbimofruese në territorin, në të cilin ajo vepron, dhe ka të drejtë të kërkojë pjesëmarrjen në mbledhjet e GTN-së të përfaqësuesve dhe profesionistëve nga struktura të tjera, sipas nevojave të identifikuara në vlerësimin fillestar të rastit.

5. Strukturat e policisë së shtetit, të shëndetësisë, arsimit, shërbimeve sociale, publike dhe private, ngarkohen me detyrimin për të përcaktuar personin përgjegjës, në nivel institucioni, që do të shërbejë si pikë kontakti, do të përfaqësojë institucionin në mbledhjet e GTN-së dhe do të sigurojë zbatimin e detyrimeve të marra përsipër, sipas PIM-it. Emrat e tyre u komunikohen drejtorit të strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki dhe Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.



6. Çdo anëtar i grupit teknik, ndërsektorial është përgjegjës për ndarjen e informacionit me drejtuesin e strukturës që përfaqëson dhe marrjen e masave për të bërë të mundur zbatimin e ndërhyrjeve apo të veprimeve të caktuara në fushën apo sektorin që përfaqëson.

7. Në rastet kur njëri nga anëtarët e GTN-së nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, mungesa duhet të justifikohet me anë të një njoftimi me shkrim, në mënyrë elektronike dhe në rrugë zyrtare. Në takim duhet të delegohet zëvendësuesi i tij, i cili ka detyrimin të marrë angazhime në emër të institucionit.

8. Drejtuesi apo anëtarët e grupit teknik, ndërsektorial mund të kërkojnë pjesëmarrjen në takimet e GTN-së të përfaqësuesve të organeve të drejtësisë, nëse e vlerësojnë si të domosdoshëm informimin dhe pjesëmarrjen e tyre për menaxhimin e rastit.

9. Gjyqtarët dhe prokurorët, si përfaqësues të organeve të drejtësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin ku bën pjesë bashkia apo njësi administrative, ftohen të marrin pjesë në takimet e grupit teknik, ndërsektorial jo me statusin e anëtarit përfaqësues.

10. Drejtuesi i grupit teknik, ndërsektorial, si dhe/ose çdo anëtar i tij duhet të sigurojë pjesëmarrjen e familjes dhe fëmijës, nëpërmjet dhënies së mendimit apo opinionëve, të shprehura në gjuhën e tij apo në një gjuhë që fëmija e kupton, në çdo fazë të procesit të mbrojtjes së fëmijës e vendimmarrjes, duke treguar edhe arsytet përkatëse për këtë.

11. Pjesëmarrja dhe e drejta për t'u dëgjuar i garantohet çdo fëmije, i cili vetë, nëpërmjet prindit/kujdestarit apo nëpërmjet një personi madhor të zgjedhur prej tij, ka të drejtë t'i kërkojë PMF-së, drejtuesit të GTN-së apo çdo anëtar i tij të dëgjohet, në kuadrin e trajtimit të rastit të tij në mbledhjet e GTN-së.

12. Në çdo rast, psikologu, çdo anëtar i GTN-së dhe drejtuesi i GTN-së sigurojnë zbatimin e një teknike miqësore të marrjes së mendimit të fëmijës, duke zbatuar parimet, si më poshtë vijon:

a) Mosdetyrimin e fëmijës për të dhënë informacion;

b) Bërjen të njohur se përse do të përdoret informacioni i dhënë dhe kufizimet e konfidencialitetit, për shkak të raportimit në GTN;

c) Mostraumatizimin e fëmijës, për shkak të intervistës;

ç) Ndjekjen e rrëfimit të lirë dhe të ritmit të fëmijës.

III. THIRRJA DHE DREJTIMI I MBLEDHJES SË GRUPIT TEKNIK NDERSEKTORIAL

1. Grupi teknik, ndërsektorial thirret kur NJMF-ja apo PMF-ja ka vlerësuar, nëpërmjet vlerësimit fillestar, se rreziku në të cilin ndodhet fëmija është i mesëm, i lartë, i menjëhershëm, ose kur rasti ka rrezik të ulët, por është shumë kompleks.

2. Njësia për mbrojtjen e fëmijës organizon punën për thirrjen e mbledhjes së grupit teknik, ndërsektorial në nivel bashkie, ndërsa punonjësi për mbrojtjen e fëmijës për atë në nivel njësie administrative dhe përgatit projektplanin individual të mbrojtjes për shqyrtim e miratim nga GTN-ja.

3. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së GTN-së bëhet me shkrim. Shkresa dërgohet paralelisht, edhe në mënyrë elektronike, nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, i ndihmuar nga NJMF-ja, në nivel bashkie, dhe PMF-ja, në nivel njësie administrative. Në njoftim tregohen në mënyrë të qartë e të detajuar çështjet që do të diskutohen.

4. Grupi teknik, ndërsektorial në nivel bashkie drejtohet nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore ose drejtuesi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve, në mungesë të tij. Grupi teknik, ndërsektorial në nivel njësie administrative drejtohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës.

5. Drejtuesi i grupit teknik, ndërsektorial ka për detyrë:

a) Të sigurojë zbatimin e dispozitave të ligjit dhe të legjislacionit në fuqi;

b) Të marrë masa për organizimin e punës për thirrjen, mbledhjen dhe funksionimin e GTN-së;

c) Të marrë masa për të siguruar pjesëmarrjen në GTN të personave që kanë ose mund të kenë njohuri për situatën e fëmijës apo që mund të kontribuojnë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës.

6. Grupi teknik, ndërsektorial bashkëpunon dhe mbështet PMF-në dhe/ose NJVRN-në në vlerësimin e plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, hartimin e planit individual të mbrojtjes, zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në PIM dhe rishikimin e tij.



IV. FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDERSEKTORIAL DHE VLERESIMI I PLOTË I RASTIT TË FËMIJËS NË NEVOJË PËR MBROJTJE

1. Gjatë vlerësimit të plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, grupi teknik, ndërsektorial, në bashkëpunim me NJMF-në/PMF-në, ka detyrimin të bëjë vlerësimin e:

- a) Nivelit të rrezikut për fëmijën;
- b) Nevojave për shërbime për fëmijën dhe familjen;
- c) Kapaciteteve dhe burimeve të fëmijës dhe familjes;
- ç) Ndërhyrjeve të nevojshme dhe veprimeve të caktuara, që duhen ndërmarrë nga organe apo struktura të caktuara, me qëllim garantimin e mbrojtjes apo të aksesit të të drejtave të fëmijës, si dhe mbrojtjes apo fuqizimit të familjes;
- d) Nevojës për marrjen e masës së mbrojtjes apo të një urdhri mbrojtjeje, në kuadër të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar;
- dh) Nevojës për të plotësuar ose për të proceduar më tej me një aplikim për azil, sipas ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Anëtarët e GTN-së, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, kanë detyrimin të:

- a) Të shkëmbejnë me NJMF-në çdo informacion të disponueshëm për situatën e fëmijës dhe familjes;
- b) Të kryejnë vizita të përbashkëta me PMF-në në mjedisin ku jeton fëmija;
- c) Të ofrojnë ekspertizë sipas fushave apo institucioneve që ata përfaqësojnë në vlerësimin e nivelit të rrezikut, nevojave për shërbime, identifikimin dhe caktimin e ndërhyrjeve të nevojshme;
- ç) Të konfirmojnë informacionin e ndarë në mbledhjen e GTN-së nga PMF-ja dhe anëtarë të tjerë të grupit, i cili do të merret parasysh gjatë hartimit të planit individual të mbrojtjes;
- d) Të mbështesin dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijës në mbledhje dhe marrjen e mendimit të tij, nëpërmjet vënies në dispozicion të mjeteve logjistike apo të mbështetjes institucionale, në rastet kur kjo kërkohet nga NJMF-ja.

V. FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDERSEKTORIAL NË MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES

1. Në përfundim të vlerësimit të plotë, anëtarët e GTN-së bien dakord për projektplanin individual për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Plan individual për mbrojtjen e fëmijës dokumentohet me formularin e planit individual të mbrojtjes (PIM), i cili përmban detyrat dhe përgjegjësitë që ndërmerren nga secili anëtar i grupit, sipas strukturës që përfaqëson, për të përmbushur nevojat e fëmijës dhe të familjes, si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre.

3. Plan individual për mbrojtjen e fëmijës plotësohet dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e grupit teknik, ndërsektorial, sipas formularit përkatës, dhe miratohet nga drejtorit i strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki. Pas miratimit nga drejtori, PMF-ja ndan zyrtarisht me të gjithë anëtarët e GTN-së PIM-in përfundimtar.

4. Në raste të veçanta, kur nevojat e fëmijës brenda PIM-it nuk adresohen plotësisht nga shërbimet brenda territorit të bashkisë apo njësisë administrative, drejtuesi i GTN-së identifikon ofruesin e shërbimit të nevojshëm më të afërt. Drejtuesi i GTN-së dhe përfaqësuesi i Shërbimit Social Rajonal, anëtar i GTN-së, përgatisin kërkesën për mbështetje nga struktura e identifikuar si shërbimofruese. Kjo kërkesë i drejtohet edhe agjencisë, në rastet kur është e nevojshme ndërhyrja në nivel qendror.

5. Çdo anëtar i GTN-së është përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve, të ndërhyrjeve apo ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në PIM-in për fëmijën, prindërit apo anëtarët e familjes së tij.

6. Çdo anëtar ka detyrimin të raportojë menjëherë te drejtuesi i GTN-së nëse një veprim, ndërhyrje apo shërbim i marrë përsipër për t'u garantuar nga ana e tyre, në kuadër të PIM-it, nuk po realizohet, duke treguar arsyet dhe shkaqet konkrete.

7. Çdo anëtar i GTN nuk mund dhe nuk duhet të presë mbledhjen e radhës së GTN-së për të referuar pamundësitë e përmbushjes së detyrave e përgjegjësiave të tij, por duhet, në mënyrë proaktive, të bashkëpunojë me strukturat e mbrojtjes në nivel vendor dhe, nëse është e nevojshme, edhe në nivel qendror, me qëllim realizimin e zbatimit të PIM-it.



8. Anëtarët e GTN-së detyrohen të bashkëveprojnë e të bashkërendojnë punën me njëritjetrin për gjetjen e zgjidhjes më të mirë, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, dhe mbajnë përgjegjësi për vendimet e marra në këto takime.

9. Drejtuesi i GTN-së informon agjencinë në rastet e mosveprimit apo të mospjesëmarrjes së pajustificuar të anëtarëve të GTN-së dhe agjencia fillon procedurën e vendosjes e të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, si dhe merr masat përkatëse, sipas nenit 69, të ligjit nr. 18/2017.

10. PMF-ja ka të drejtë të kërkojë informacion, sipas afateve të përcaktuara në PIM, për realizimin e ndërhyrjeve, të shërbimeve dhe detyrave të tjera të anëtarëve të GTN-së dhe autoriteteve të tjera, te të cilat është referuar rasti.

11. PMF/NJMF-ja referon tek agjencia rastet kur autoritetet shtetërore nuk bashkëpunojnë e ndihmojnë në aksesin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, me qëllim zbatimin e sanksioneve të parashikuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

VI. FUNKSIONET E GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL NË RISHQYRTIMIN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES DHE MBYLLJEN E RASTIT

1. GTN-ja ka detyrimin të bëjë rishqyrtimin formal të PIM-it të fëmijës në nevojë për mbrojtje të paktën 6 javë, pas hartimit të planit të parë, dhe, në mënyrë periodike, çdo 3 muaj.

2. Paraprakisht, nga anëtarët e GTN-së ose për shkaqe të justifikuara, drejtuesi i GTN-së mund të vendosë që mbledhjet për rishqyrtimin e PIM-it të fëmijës në nevojë për mbrojtje të bëhen para afatit të parashikuar ose më shpesh, në varësi të situatës dhe nevojave.

3. Në takimin e rishqyrtimit të PIM-it, të gjithë anëtarët raportojnë për zbatimin e planin, rezultatet që janë arritur dhe ndryshimet që ata propozojnë për uljen e nivelit të rrezikut.

4. PMF-ja merr masa për reflektimet e ndryshimeve në PIM, bazuar në shënimet e bëra në formularin përkatës, i cili firmoset nga anëtarët e grupit teknik, ndërsektorial.

5. PMF-ja raporton te GNT-ja për mbylljen e rastit nëse, pas rishqyrtimit të PIM-it, rezulton se:

a) veprimet, ndërhyrjet e ndërmarra dhe shërbimet e ofruara sipas PIM-it janë kryer dhe se fëmija është jashtë rreziku e nuk ka shqetësime të tjera për të;

b) fëmija ka mbushur moshën 18 vjeç. Nëse PMF-ja vlerëson se fëmija ka ende nevojë për shërbime, rasti do të referohet për marrjen e shërbimeve të përshtatshme të strukturat që mbulojnë shërbime për këtë grup-moshë dhe në përputhje me nevojat e individit;

c) fëmija vdes;

ç) fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim dhe dosja e tij është transferuar.

6. Në çdo rast, vendimi për mbylljen e rastit merret nga drejtori i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki, bazuar në rekomandimin e NJMF-së, pas rishqyrtimit të PIM-it në GTN.

VII. DOKUMENTIMI I MBLEDHJEVE TË GRUPIT TEKNIK, NDËRSEKTORIAL

1. Diskutimet në lidhje me rastin e fëmijës në nevojë për mbrojtje, si dhe komentet e çdo anëtari, që nuk bie dakord me propozimet për nivelin e rrezikut apo mënyrën e ndërhyrjes, regjistrohen në procesverbalin e takimit, i cili firmoset, më pas, nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës.

2. NJMF-ja apo PMF-ja përgatit dhe qarkullon procesverbalin brenda një jave, në formë të shkruar dhe nëpërmjet postës elektronike, për të vërtetuar saktësinë e përmbajtjes. Në takimin e radhës, procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e GTN-së.

VENDIM

Nr. 118, datë 4.6.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SONNE” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK TOPOJË, ME FUQI TË INSTALUAR 1998 kw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”; neni 5, pika 1, germa “a” dhe neni 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”; bordi i ERE-s, në mbledhjen e



tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 3 prot., datë 1.2.2018, protokolluar në ERE me nr. 149 prot., datë 2.2.2018, shoqëria “SONNE” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 53, datë 7.3.2018, vendosi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet prodhues 1998 kw, për shkak të mangësive në dokumentacionin e depozituar.

- Me shkresën nr. 6 Prot., datë 30.3.2018, dhe protokolluar në ERE me nr. 149/3 prot., datë 3.4.2018, shoqëria “SONNE” sh.p.k., ka riaplikuar për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Në nenin 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: “Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimi për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.”

- Rezulton se aplikimi i shoqërisë është paraqitur brenda afateve të parashikuara në dispozitat më sipër.

- Shoqëria “SONNE” sh.p.k. ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën me nr. 2278 rep. dhe nr. 1052/3 kol., datë 12.10.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik Topojë”, me kapacitet prodhues 1998 kw, në Bashkinë Fier, qarku Fier, bazuar në nenin 25 të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015.

- Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 89, datë 20.4.2018, u shpreh për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, Fier me kapacitet të instaluar 1998 kw, për një afat 20-vjeçar.

- Me shkresën nr. 55/19 prot., datë 24.4.2018, është bërë njoftimi në median e shkruar, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik dhe pas përfundimit të afatit 20-ditor të paraqitjes së objeksioneve ose ankesave, lidhur me këtë aplikim, nuk rezulton të jetë depozituar në ERE asnjë ankesë ose objeksion.

- Aplikimi i shoqërisë “SONNE” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, ghermat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “SONNE” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, Topojë, me fuqi të instaluar 1998 kw, për një afat 20-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 119, datë 4.6.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “BLAÇ ENERGY” SHPK,
PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA HEC
“BLAÇ”, ME FUQI TË INSTALUAR
1300 kw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “BLAÇ Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “BLAÇ Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën e protokolluar në ERE me nr. 379 prot., datë 10.5.2018, për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “BLAÇ”, me fuqi të instaluar 1300 kw.

- Aplikimi i shoqërisë “BLAÇ Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata);

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit) do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BLAÇ Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “BLAÇ”, me fuqi të instaluar 1300 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 120, datë 4.6.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2018 TË
SHOQËRISË ALBGAS SHA**

Në mbështetje të neneve 16 pika 12; 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; neneve 8; 9 dhe 10, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me



vendimin e bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.1.2018; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës, për fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve të shoqërisë ALBGAS sh.a., për vitin 2018,

konstatoi se:

- ALBGAS sh.a., në cilësinë e Operatorit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror, nëpërmjet shkresës me nr. 43 prot., datë 21.3.2018, ka dërguar pranë ERE-s “Planin 10-vjeçar të zhvillimit (2018–2027)”;

- Kryetari i ERE-s nëpërmjet urdhrit nr. 32, datë 28.3.2018, urdhëroi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin dhe analizimin e planit 10-vjeçar të zhvillimit të ALBGAS sh.a.;

- Grupi i punës analizoi materialin e paraqitur pranë ERE-s “Plani dhjetëvjeçar i zhvillimit”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAS sh.a. në takimin e tij të datës 9.2.2018.

Në vijim u zhvilluan takime të përbashkëta me specialistët e ALBGAS sh.a., me qëllim përmirësimin e aplikimit e si rezultat u paraqitën pranë ERE-s materiale shtesë.

- Në zbatim të ligjit nr. 102/2015, neni 16, pika 12, ERE ka përgjegjësinë të miratojë planet e investimeve të të licencuarve në sektorin e gazit natyror, si dhe të kryej mbikëqyrjen e tyre. Sipas kërkesave të nenit 46 dhe 56 të këtij ligji, ERE shqyrton dhe miraton planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetim/shpërndarjes së gazit natyror nga ALBGAS sh.a.

- Gjatë analizimit të materialeve u konstatua:

a) Investimet përmirësojnë nivelin e operimit dhe shërbimit;

b) Përgjithësisht investimet ndikojnë pozitivisht në uljen e humbjeve në rrjet;

c) Evidentohet përpjekja për minimizimin e kostove në studimin e parashikimin e investimeve;

d) Nga analizimi i relacioneve shpjeguese, gjykohet se të dhënat janë mjaftueshëm të detajuara për fazën e miratimit të fillimit të procedurave;

e) Për investimet kryesore dallohet analizimi dhe vlerësimi me alternativë;

f) Investimet e parashikuara janë në zbatim të

strategjisë së zhvillimit afatgjatë për sektorin e gazit natyror;

g) Plani i paraqitur për investimet bazohet kryesisht në marrëveshjen për mbulim financiar për ngritjen e kapaciteteve nga ana e TAP AG dhe nga pikëpamja kohore duket i realizueshëm.

- Viti 2018 është viti i cili parashikon projekte të reja, kryesisht të përqendruara te përshtatja e rrjetit në mënyrë që të përballojë sasinë e gazit të transmetuar, trajnimi i stafit, si dhe pajisja me mjetet e duhura për të pasur një punë sa më të frytshme me standarde evropiane. Gjithashtu, gjatë vitit 2017 u evidentua fakti se sektori i gazit në Shqipëri, me infrastrukturë të ngritur që prej vitit 1971 ka nevojë për mirëmbajtje dhe investime të vazhdueshme në mënyrë që të minimizohen humbjet e gazit dhe të kryhet aktiviteti parësor i transmetimit dhe shpërndarjes të gazit natyror. ALBGAS sh.a. fillimisht po shfrytëzon linjat e transmetimit të gazit. Linjat e shpërndarjes janë ende në proces, momentalisht nuk ka aktivitet për shpërndarjen e gazit natyror, deri sa të kryhet rinovimi i infrastrukturës së gazsjellësit. Kjo pritet të realizohet në kuadër të investimeve strategjike me rëndësi kombëtare (Gas Masterplan), ku gazsjellësi TAP AG do të ketë rol suportues në konceptimin, planifikimin dhe implementimin e projektit.

- Shoqëria Albgas sh.a. ka hartuar planin e investimeve në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Albgas sh.a., si dhe krijimit të një strukture funksionale për operimin e transmetimit të gazit e cila është paraqitur në vijim.

- Mbulimi financiar i tyre është i parashikuar kryesisht në marrëveshjen për ngritjen e kapaciteteve me shoqërinë TAP AG.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Planit të investimeve të shoqërisë ALBGAS sh.a. për vitin 2018” (bashkëlidhur).

2. “ALBGAS” sh.a. të depozitojë pranë ERE-s, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave:

- Miratimet nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Investimeve për vitin 2018 që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015.



- Argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Tabela e investimeve 2018 të ALBGZ sh.a.

Nr.	Emertimi i Investimeve 2018	Koha e pritshme e venies ne pune	Vlera e Investimit (ALL)	Jetegjatesia e pritshme (vite)	Amortizimi vjetor i pritshem	Burimi i Financimit	
						Kap.Vetja k (leke)	Grante (leke)
I	Remont Kapital Makineri dhe automjete	6 muj. II	12,000,000	30	66,667	2,000,000	10,000,000
	Pjese per kompresorin B2S		400,000			400000	
	Tubo naftesjellesi Φ 4"		149,691			149691	
	Tubo naftesjellesi Φ 8"		128,646			128646	
	Tubo naftesjellesi Φ 10"		130,000			130000	
	Tubo naftesjellesi Φ 12"		108,333			108333	
	Tubo naftesjellesi Φ 13"		1,083,330			1083330	
	Automjete SUV Pick up		10,000,000				10,000,000
II	Ngritje Kapaciteti	6 muj. II	6,075,000	50	121,128	6,075,000	
	1 Pajisje kompjuterike per zyrtar Fier		1,938,000			1938000	
	2 Literature inxhinjerike		200,000			200000	
	3 Sisteme Acces Control; Video mbikqyrje per zyrtar Tirane		737,000			737000	
	4 Domain dhe Hostim Website zyrtar i Shoqerise		100,000			100000	
	5 Pajisje per mbrojtjen e shendetit dhe sigurise ne pune		3,100,000			3100000	
III	Ndertim-Montim-Tubacione	6 muj. II	17,000,000	33	515,152		17,000,000
	1 Linja Ballsh-Fier, tubacioni D=8", L=20m		850,000		25,758		850000
	2 Linja Ballsh-Fier, tubacioni D=6", L=30m		1,275,000		38,636		1275000
	3 Linja Ballsh-Kash, tubacioni D=4", L=150m		6,375,000		193,182		6375000
	4 Linja Fier-Frakull, tubacioni D=4", L=200m		8,500,000		257,576		8500000
IV	Rikonstruksion Zyra Fier dhe Magazinat	6 muj. II	89,259,120		1,424,258		89,259,120
	Rehabilitim I rrugës hyrëse dhe sheshit për magazinim		7,806,000				7,806,000
	1 Rikonstruksion i godinave ekzistuese Fier		35,565,669	67	530,831		35,565,669
	2 Ndertimi i dy magazinave me konstrukt metalik		44,671,331	50	893,427		44,671,331
	Sherbime projektim,kolaudim,Mbikqyrje		1,216,120				1,216,120
V	Informatizimi	6 muj. II	10,064,000				10,064,000
	1 Software inxhinjerik dhe programe per monitorimin e projekteve						
	2 Ploter inxhinjerik per formatet A0,A1,A2						
VI	Pajisje dhe Orendi	6 muj. II	14,850,000	10	1,485,000		14,850,000
	1 Pajisje rlevuese						
	2 Pajisje matese						
	3 Pajisje inspektuese dhe testuese						
	4 Pajimi PPE						
VII	Te tjera	6 muj. II	1,380,000				1,380,000
	Totali Investimeve 2018		150,628,120			8,075,000	142,553,120

**VENDIM****Nr. 121, datë 4.6.2018****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E PLANIT 10-VJEÇAR TË
ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË
SHOQËRISË ALBGAZ SHA**

Në mbështetje të neneve 16 pika 12; 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; neneve 8; 9 dhe 10, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.1.2018; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, për fillimin e procedurës për miratimin e Planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAZ sh.a.,

konstatoi se:

- ALBGAZ sh.a., në cilësinë e Operatorit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror, nëpërmjet shkresës me nr. 43 prot. datë 21.3.2018, ka dërguar pranë ERE-s “Planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit (2018–2027)”.

- Kryetari i ERE-s nëpërmjet urdhrit nr. 32, datë 28.3.2018, urdhëroi ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin dhe analizimin e Planit 10-vjeçar të zhvillimit të ALBGAZ sh.a.

- Grupi i punës analizoi materialin e paraqitur pranë ERE-s, “Plani dhjetëvjeçar i zhvillimit”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAZ sh.a. në takimin e tij të datës 9.2.2018.

- Në vijim u zhvilluan takime të përbashkëta me specialistët e ALBGAZ sh.a., me qëllim përmirësimin e aplikimit e si rezultat u paraqitën pranë ERE-s materiale shtesë.

- Në zbatim të ligjit nr. 102/2015, neni 16, pika 12, ERE ka përgjegjësinë të miratojë planet e investimeve të të licencuarve në sektorin e gazit natyror, si dhe të kryejë mbikëqyrjen e tyre. Sipas kërkesave të neneve 46 dhe 56 të këtij ligji, ERE shqyrton dhe miraton planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetim/shpërndarjes së gazit natyror nga ALBGAZ sh.a.

- Gjatë analizimit të materialeve u konstatua:

a) Investimet përmirësojnë nivelin e operimit dhe shërbimit

b) Përgjithësisht investimet ndikojnë pozitivisht në uljen e humbjeve në rrjet.

c) Evidentohet përpjekja për minimizimin e kostove në studimin e parashikimin e investimeve.

d) Nga analizimi i relacioneve shpjeguese gjykohet se të dhënat janë mjaftueshmërisht të detajuara për fazën e miratimit të fillimit të procedurave.

e) Për investimet kryesore dallohet analizimi dhe vlerësimi me alternativë

f) Investimet e parashikuara janë në zbatim të strategjisë së zhvillimit afatgjatë për sektorin e gazit natyror.

g) Plani i paraqitur për investimet bazohet kryesisht në marrëveshjen për mbulim financiar për ngritjen e kapaciteteve nga ana e TAP AG dhe nga pikëpamja kohore duket i realizueshëm.

- Gjatë vitit 2017 u evidentua fakti se sektori i gazit në Shqipëri, me infrastrukturë të ngritur që prej vitit 1971 ka nevojë për mirëmbajtje dhe investime të vazhdueshme në mënyrë që të minimizohen humbjet e gazit dhe të kryhet aktiviteti parësor i transmetimit dhe shpërndarjes të gazit natyror. ALBGAZ sh.a. fillimisht po shfrytëzon linjat e transmetimit të gazit. Linjat e shpërndarjes janë ende në proces, momentalisht nuk ka aktivitet për Shpërndarjen e gazit natyror, deri sa të kryhet rinovimi i infrastrukturës së gazsjellësit. Kjo pritet të realizohet në kuadër të investimeve strategjike me rëndësi kombëtare (Gas Masterplani), ku gazsjellësi TAP AG do të ketë rol suportues në konceptimin, planifikimin dhe implementimin e projektit.

- Shoqëria ALBGAZ sh.a. ka hartuar planin 10-vjeçar të zhvillimit në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të ALBGAZ sh.a., si dhe krijimit të një strukture funksionale për operimin e transmetimit të gazit e cila është paraqitur në vijim.

- Mbulimi financiar i tyre është i parashikuar kryesisht në marrëveshjen për ngritjen e kapaciteteve me shoqërinë TAP AG.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë ALBGAZ sh.a.”



2. “ALBGAS” sh.a. të depozitojë pranë ERE-s, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave:

- Miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, të planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2018–2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.5.2015.

- Argumentime më të detajuara lidhur me projektet.

3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

PLANI 10-VJEÇAR I ZHVILLIMIT TË RRJETIT

GRUP INVESTIMET E PARASHIKUARA NGA ALBGAS sha GJATË PERIUDHËS 2018-2027										
Emertimi i Investimit	Vlera e Investimit (ALL)			Vlera e Investimit (EURO)						
	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
Remont Kapital Makin dhe Automjete	12,000,000									
Ngritje Kapaciteti Teknik	6,075,000									
Ndertim-Montim-Tubacione	17,000,000									
Rihabilitim Zyra Fier dhe Magazinat	89,259,020									
Informatizimi bashkëkohor	10,064,000									
Pajisje dhe Orendë	14,850,000									
Te Tjera	1,380,000									
Projekti Prioritar PIP01 (TPP Vlora-Fier) Opsioni A- 39.9 km		14,000,000								
Projekti Prioritar PIP01 (TPP Vlora-Fier) Opsioni B- 46.1 km (22 000 000 Lek)										
Mirembajtja dhe riprertitja e tubacioneve ekzistues		30,000,000								
Hartim Projekti PIP2 (Fier-Ballsh)							300,000			
Projekti Prioritar PIP2 (Fier-Ballsh) Opsioni A- 39km							11,500,000			
Projekti Prioritar PIP2 (Fier-Ballsh) Opsioni B- 38km (11 800 000 Lek)										
Hartim Projekti PIP3 (Tirane-Durres)							200,000			
Projekti Prioritar PIP3 (Tirane-Durres) Opsioni A- 14.5km							5,000,000			
Projekti Prioritar PIP3 (Tirane-Durres) Opsioni B- 16.7km (5 200 000 Lek)										
PRMS Korce (Pression Reduction & Metering Station)							2,500,000			
	150,628,020	44,000,000					19,500,000			

**VENDIM****Nr. 122, datë 4.6.2018**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
FURNIZIMIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE
SHA), MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 112, DATË
8.7.2016 E VLEFSHME DERI MË DATË
8.7.2021 TE SHOQËRIA “FURNIZUESI I
SHËRBIMIT UNIVERSAL” SHA
(FSHU SHA)**

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa “d”; 37, pika 2, germa “c” dhe nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 2 dhe 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, i ndryshuar, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “c”; 5, pika 1, germa “c”; 10, pika 3; 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 te shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), e vlefshme deri në datën 8.7.2021,

konstatoi se:

-Shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën me nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, ka përcjellë dokumentacionin për transferimin e

licencave/licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a. dhe me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018 shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.) ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin licencës së furnizimit të energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.).

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar pranë ERE-s në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016.

- Me shkresën nr. 1090/1 prot., datë 6.4.2018, OSHEE sh.a. ka bërë me dije themelimin e shoqërisë “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.), në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe urdhrin të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018, të shoqërisë OSHEE sh.a. në cilësinë e aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018.

- Aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim (neni 17, pika 2, germa “a”, formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa “b”, dokumentet juridike, administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa “c”, dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3, gjerat “b”, “c”, “d”), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 2, germa “d” (çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.) Diagrama e sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistues dhe ata të perspektives – Subjekti nuk deklaroi që ka modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike ose reflektim të ndryshimeve.



- Neni 17, pika 4, germa “a” (formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “b” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3 germa “a” (vërtetime që shoqëria nuk ka detyrime për tatim – taksa dhe ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore);

- Nenin 17, pika 4, germa “c” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës), do të njoftohet shoqëria që në bazë të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” neni 11, pika 1, t’i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës së Furnizimit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016 e vlefshme deri me datë 8.7.2021, të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.),

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 123, datë 4.6.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
OPERIMIT NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE
SHA), ME NR. 250, SERIA P14SH,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERVE TË ERE-s NR. 96,
DATË 27.10.2014, E VLEFSHME DERI MË
DATË 27.10.2044 TE SHOQËRIA
“OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES” SHA (OSSH SHA)**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “c”, 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “c”; 5, pika 1 germa “c”; 10, pika 1, si dhe të nenit 17, pika 1, pikat 2, 4 dhe 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19 pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së operimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e bordit të komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2044 të shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.),

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014 dhe mban licencën me nr. 250, seria P14SH.



- Me shkresën nr. 1090/1 prot., datë 6.4.2018, OSHEE sh.a. ka bërë me dije themelimin e shoqërisë “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes”(OSSH), në zbatim të Ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe urdhrit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a. në cilësinë e Aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018, me ofertë private, me objekt aktiviteti shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë, me NUIS L81530018E.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën me nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 355, datë 30.4.2018, ka përcjellë dokumentacioni për transferimin/licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a..

- Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH) me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018, ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin licencës së shpërndarjes të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërive “OSHEE” sh.a. dhe “OSSH” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në bazë të nenit 10, pikat 1 dhe 2, si dhe nenit 17 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 17, pika 2, germa “a”, formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa “b”, dokumentet juridike, administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa “c”, dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 gjerat “b”, “c”, “d”), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 2, germa “d”: (çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.) Diagrama e sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistues dhe ata të perspektives – Subjekti nuk deklaroi që ka modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike ose reflektim të ndryshimeve.

- Neni 17, pika 4, germa “a” (formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “b” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3 germa “a” (vërtetime që shoqëria nuk ka detyrime për tatimtaksa dhe ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore);

- Nenin 17, pika 4, germa “c” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës), do të njoftohet shoqëria që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferim e licencës së Operimit në Sistemin e Shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE), mbajtëse e licencës nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2044 të shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH),

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 124, datë 4.6.2018**

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS,
PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “GAVRAN ENERGY” SHPK
ME NR. 349 LICENCE, SERIA PV16K,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
NR. 140, DATË 15.8.2016, PËR
PRODHIMIN TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-et “GAVRAN 1”,
ME FUQI TË INSTALUAR 998 kw DHE
“GAVRAN”, ME FUQI TË INSTALUAR
1215 kw, ME FUQI TOTALE TË
INSTALUAR 2213 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 8, pikat 1 dhe 2, 10, pika 1 dhe 3 dhe nenit 15, pika 2, germa “a”; pika 4, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe neneve 15 dhe 19 pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi mosfillimin e procedurës për modifikimin e licencës në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Garvan Energy” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 15.8.2016, është e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1” me fuqi të instaluar 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi të instaluar 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw, për një afat 30-vjeçar dhe disponon licencën me nr. 349, seria PV16K.

- Shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k., me shkresën e datës 13.5.2016, protokolluar në ERE me nr. 370, datë 8.5.2018, ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës me nr. 349, seria PV16K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 140, datë 15.8.2016.

- Aplikimi i shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin A (neni 8, pika 2) nuk është plotësuar.

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) nuk është plotësuar.

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (neni 15, pika 4, germa “b”), nuk është plotësuar.

- Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (neni 15, pika 4, germa “c”) nuk është plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., me nr. 349, seria PV16K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 140, datë 15.8.2016, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Gavran 1”, me fuqi të instaluar 998 kw dhe “Gavran”, me fuqi të instaluar 1215 kw, me fuqi totale të instaluar 2213 kw.

2. Nëse shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k. paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6, të nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda 1 muaji nga marrja e këtij vendimi dokumentacioni i vlefshëm i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 125, datë 4.6.2018****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AED SOLAR” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK TOPOJË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1998 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1 germa “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW, konstatoi se:

- Me shkresën nr. 3 prot., datë 1.2.2018, shoqëria “AED Solar” sh.p.k., paraqiti në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 54, datë 7.3.2018, ka vendosur për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet prodhues 1998 KW për shkak të mangësive në dokumentacionin e depozituar.

- Me shkresën me nr. 5 prot., datë 30.3.2018 dhe protokolluar në ERE me nr. 148/3, datë 3.4.2018, shoqëria “AED SOLAR” sh.p.k., ka riaplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW.

- Në bazë të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se: “Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.”

- Sa më sipër, rezulton se aplikimi i shoqërisë ka ardhur brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

- Në vijim bordi i ERE-s, me vendimin nr. 88, datë 20.4.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier me kapacitet të instaluar 1998 kw.

- Me shkresën nr. 55/21 datë 24.4.2018, është bërë njoftimi në media, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “AED Solar” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga centrali fotovoltaik dhe mbas përfundimit të afatit të paraqitjes së objeksioneve ose ankesave, nuk rezulton të jetë paraqitur në ERE, ankesë ose objeksion nga subjekte ose persona fizikë mbi këtë aplikim.

- Shoqëria “AED SOLAR” sh.p.k. ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kontratën me nr. 2608 rep. dhe nr. 1227/3 kol, datë 17.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik Topojë” me kapacitet prodhues 1998 kw, në Bashkinë Fier, qarku Fier, bazuar në nenin 25 të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015.

- Aplikimi i shoqërisë “AED SOLAR” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4, 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “AED SOLAR” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë me kapacitet të instaluar 1998 kw, për një afat 20-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 126, datë 4.6.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “WIND POWER ALBANIA” SHPK, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika, germa “d” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 21 prot., datë 5.4.2018, shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 91, datë 20.4.2018, vendosi “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të vendimit të fillimit të procedurës me shkresën nr. 55/28 prot., datë 7.5.2018 është bërë njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe pika 4.7.1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Wind Power Albania” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3462, datë 17.4.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Petrit Çela, i datëlindjes 2.5.1935, si dhe caktimin e shtetases Mimoza Arapi (Çela), e datëlindjes 31.1.1973, si kujdestare për administrimin e pasurisë së shtetasit Petrit Çela.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë